

NEWSLETTER PROGRAMI CONNECT ALBANIA

2021

Nr. 11



CONNECT
ALBANIA

Connect Albania (CA)

Shënim për lexuesin:


Komuniteti shqiptar në diasporë po e konsideron mekanizmin e Connect Albania si një mundësi të mirë për të qenë të përfshirë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Agjentët e Zhvillimit janë si një urrë lidhëse midis vendeve ku gjendet diaspora dhe atdheut të tyre për të lehtësuar investimet e huaja në Shqipëri. Aplikimet për tu bërë Agjent Zhvillimi kanë ardhur duke u rritur çdo javë. Ky numër i buletinit informativ i dedikohet Zj. Semanta Hoti. Lista e plotë e të gjithë Agjentëve të Zhvillimit gjendet online në linkun: <https://www.adbc.al/regjistri-publik-i-agjenteve-te-zhvillimit-te-inte-resuar/>

Semanta Hoti dhe përfshirja e saj aktive në tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri

Zj. Semanta Hoti lindi në Durrës. Ajo kreu studimet në Universitetin e Tiranës dhe morri diplomën Bachelor në Drejtësi. Më vonë u zhvendos në Belgjikë ku përfundoi studimet Master për të Drejtën Ndërkombëtare dhe Europiane në Universitetin e Antverpit. Që nga ajo kohë ajo ka marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në trajnime dhe kualifikime të ndryshme profesionale në fushën e drejtësisë. Në vitin 2020 ajo ndoqi dhe përfundoi me sukses kursin "E drejta transnacionale I – Qeverisja private dhe rregullat përkatëse", A (Magna Cum Laude)" në Universitetin e Bremenit në Gjermani. Në të njëjtin vit filloi edhe programin "Kredencialet e lidhshimit publik, Shkenca politike dhe Qeveria" në Shkollën Harvard Kennedy në SHBA.

Zj. Hoti ka një karrierë profesionale mjaft intensive dhe të sukseshme. Ajo është partnere themeluse dhe drejtoreshë e kompanisë "Hoti Legal Enterprise & Investments" në Shqipëri, ku ofron asistencë dhe shërbime për çështjet ligjore që lidhen me migracionin, të drejtën civile dhe tregtare si edhe kodin penal. Ajo është njëkohësisht edhe drejtuesja për Shqipërinë në kompaninë ligjore "A-Law International Law Firm" në Antverp të Belgjikës. Më specifikisht ajo ofron ekspertizë në të drejtat e njeriut, përgjegjësinë sociale të korporatave dhe tregtinë ndërkombëtare. Ajo është duke asistuar kompanitë e huaja për përgatitjen e një modeli të saktë biznesi bazuar në normat ndërkombëtare. Tashmë si një Agjente Zhvillimi, ajo është duke bashkëpunuar me Ambasadën e Shqipërisë në Belgjikë për promovimin e Shqipërisë tek investitorët e mundshëm. Përveç kësaj, ajo ofron mbështetje për kompanitë ndërkombëtare në sektorin e ndërtimit, pasurive të paluajtshme, shëndetësisë si edhe bashkëpunimin logjistik midis Portit të Antverpit dhe Portit të Durrësit. Puna e saj përfshin asistencën ndaj investitorëve të huaj që mund të operojnë në Shqipëri për të hartuar plane dhe modele biznesi sipas standarteve ndërkombëtare.

Ajo shfaqet mjaft entuziaste që është përfshirë në Connect Albania teksa shprehet se *"si Agjente Zhvillimi, do të punoj në sektorin e investimeve në Shqipëri me qëllimin për të tërhequr investimet e huaja dhe në këtë mënyrë të kontribuoj drejtpërdrejt në krijimin e bizneseve të sukseshme mbi bazën e marrëveshjeve të duhura dhe rregullave të Connect Albania"*



Mekanizmi Connect Albania është një pjesë e rëndësishme e programit "Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë". Ai synon të kontribuojë në rritjen e investimeve të huaja në Shqipëri. Programi zbatohet nga Zyra në Shqipëri e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) – Agjencia e Migrimit e OKB-së, me financimin e Ministrisë Italiane për Punët e Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrin e Shtetit për Diasporën të Shqipërisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si edhe Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS).



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN



MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISE

